



Titulli i projektit

Vënia në funksionim i kanalit vaditës në fshatin Babinë të Komunës Tropojë

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt

Vendndodhja e projektit

Fshati Babinë dhe Sopot, Komuna Tropojë

Buxheti i paravlerësuar

6,500,000 lekë

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Sistemi ekzistues i ujitjes në bujqësi nuk mbulon nevojat e fermerëve për vaditjen e tokave bujqësore. Në vitin 2014, ujitet vetëm 27% e sipërfaqes së mbjellë ose 42% e sipërfaqes potenciale (në krahasim me një standard prej 70% të totalit të fondit tokës që duhet të ujitet). Komuna e Tropojës ka sipërfaqen më të madhe të tokës bujqësore në zonën e Tropojës, rreth 1900 ha nga 7300 ha që ka e gjithë zona funksionale Tropojë. Nga kjo sipërfaqe, vetëm rreth 500 ha (ose 27% e sipërfaqes) ujitet. Kjo ka ndikuar edhe në rendimentin e prodhimit, si dhe lënien djerrë të tokave. Babina dhe Sopoti kanë sipërfaqen më të madhe në komunën e Tropojës dhe të zonës së Tropojës në përgjithësi. Vënia në funksionim e kanalit ujitës Begaj-Babinë prej 5 km do të ndikonte ndjeshëm në rritjen e prodhimit bujqësor në Babinë dhe Sopot dhe në Komunën e Tropojës dhe zonën funksionale Tropojë në përgjithësi.

Qëllimi/et specifik të projektit

Rritja e prodhimit bujqësor në Komunën e Tropojës nëpërmjet rritjes së aftësisë ujtëse për tokën bujqësore në Babinë dhe Sopot.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

1. Sipërfaqja bujqësore e ujitur në Bobinë dhe komunën Tropojë është rritur ndjeshëm.
2. Të ardhurat e fermerëve të Bobinës dhe komunës së Tropojës janë rritur.
3. Furnizimi me produkte bujqësore dhe blektorale për zonën funksionale Tropojë është përmirësuar.

Rreth 200 familje fermere me rreth 1000 banorë do të përfitojnë nga ky projekt. Fermerët e Babinës dhe Sopotit të komunës Tropojë do të përfitojnë direkt nga ky projekt. Në komunën Tropojë, që zë rreth 20% të territorit të zonës funksionale, jetojnë rreth 20% e popullsisë së zonës. Indirekt, do të përfitojnë banorët e qytetit Bajram Curri, si dhe bizneset e përqendruara në shërbime dhe turizëm në komunat e tjera sidomos atë të Margegajit.



Aktivitetet e projektit

1. Përgatitja e projektit teknik për ndërtimin e kanalit vaditës Begaj-Babinë, 5 km i gjatë.
2. Tenderimi i punimeve për ndërtimin e kanalit vaditës Begaj-Babinë.
3. Realizimi i punimeve për vënien në funksionim të kanalit vaditës (gërmime, pastrime, betonime, ndërtimi i pusetave, etj.)
4. Takime ndërgjegjësuese me fermerët, shoqatën e përdoruesve të ujit për përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të ujit për vaditje.

Maturimi i projektit

Projekti është në fazën e projekt-idesë. Nuk ka ndonjë studim fizibiliteti apo studim të detajuar / projekt teknik për këtë projekt. Kostoja është një paravlerësim i përafërt. Kanali ekziston, por është i dëmtuar dhe jo funksional.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimet e financimit mund të jenë nëpërmjet fondeve publike (të qeverisjes vendore apo qendrore, si Ministria e Bujqësisë), apo të donatorëve të huaj që mbështesin zhvillimin e bujqësisë në Shqipëri.

Kostot e projektit

Kostoja totale e projektit është 6,500,000 lekë, përfshirë:

1. Përgatitja e projektit teknik për ndërtimin e kanalit vaditës Begaj-Babinë, 5 km i gjatë (500,000 lekë)
2. Tenderimi i punimeve për ndërtimin e kanalit vaditës Begaj-Babinë (pa kosto).
3. Realizimi i punimeve për vënien në funksionim të kanalit vaditës (gërmime, pastrime, betonime, ndërtimi i pusetave, etj.) (6,000,000 lekë).
4. Takime ndërgjegjësuese me fermerët, shoqatën e përdoruesve të ujit, për përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të ujit për vaditje (pa kosto)